

UDHËZIM
Nr. 2225, datë 13.5.2013

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE NË AVIACIONIN CIVIL

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 9 pika 2 të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 6, pika (dh) të ligjit 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për shërbimet e ofruara nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të jenë sipas lidhjeve nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6 që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.
2. Të ardhurat, që realizohen nga shërbimet, të administrohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në masën dhe sipas kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 10 233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar.
3. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij udhëzimi.
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Oldashi

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

LIDHJA NR. 1: TARIFAT E PAGESAVE PËR LICENCË

(000/lekë)

Nr.	EMËRTIMI	AFATI	VLERA	SHËNIME
1	Licencë për operime ajrore ndërkombëtare të rregullta	1 vit 5 vjet	200,000 1,000,000	
2	Licencë për operime ajrore ndërkombëtare jo të rregullta	1 vit 5 vjet	50,000 250,000	
3	Licencë për operime ajrore të brendshme të rregullta	1 vit 5 vjet	30,000 1,000,000	
4	Licencë për operime ajrore të brendshme jo të rregullta	1 vit 5 vjet	20,000 100,000	
5	Licencë për aviacionin e përgjithshëm	1 vit 5 vjet	50,000 250,000	

LIDHJA NR. 2: TARIFAT E PAGESAVE PËR CERTIFIKATAT E OPERATORËVE AJRORË

(000/lekë)

Nr.	EMËRTIMI	AFATI	VLERA	SHËNIME
1	Certifikatë e operimit ajror (COA) ndërkombëtare të rregullta	6 muaj 1 vit	100,000 500,000	
2	(COA) ndërkombëtare jo të rregullta	6 muaj 1 vit	50,000 100,000	
3	(COA) të brendshme të rregullta	6 muaj 1 vit	25,000 50,000	
4	(COA) të brendshme jo të rregullta	6 muaj 1 vit	10,000 25,000	
5	Certifikatë për operime të aviacionit të përgjithshëm	6 muaj 1 vit	10,000 25,000	
6	Përsëritja e licencave dhe certifikatave sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2			Aplikohet po ajo tarifë

LIDHJA NR. 3: TARIFAT E PAGESAVE PËR DOKUMENTET E AVIONIT

(000/lekë)

NR.	EMËRTIMI	AFATI	VLERA	SHËNIME
1	Certifikatë e regjistrimit të avionit: Avionë me peshë deri në 3,000 kg Avionë me peshë mbi 3,000 kg	Pa afat	5,000 me formulë $5,000 + (1,000 \text{ L për çdo } 1,000 \text{ kg})$	
2	Leja për të kryer fluturimet "ferry"		25000	
3	Certifikata e vlefshmërisë ajrore: Avionë me pesha nën 5,700 kg Avionë me pesha mbi 5,700 kg	1 vit	20,000 me formulë $20,000 + (100,000 \text{ L për çdo } 1,000 \text{ kg})$	
4	Përsëritja e certifikatës së vlefshmërisë		20,000	Paguhet tarifa më e vogël
5	Certifikata e vlefshmërisë për Gliderin	1 vit	10 000	
6	Certifikata e zhurmave	pa afat	20 000	
7	Manuali i operimeve	pa afat	25,000	Për çdo amendim, 10% e shumës së tarifës
8	Manuali i fluturimit	pa afat	25,000	Për çdo amendim, 10% e shumës së tarifës
9	Manuali i mirëmbajtjes	pa afat	25,000	Për çdo amendim, 10% e shumës së tarifës

LIDHJA NR 4: APROVIMET NGA AAC

(000/lekë)

NR.	EMËRTIMI	AFATI	VLERA	SHËNIME
1	Aprovimi i qendrave të mirëmbajtjes	vit	100,000	
2	Kryerja e një testi fluturimi		15,000	
3	Aprovimi i qendrave të trajnimit	vit	100,000	
4	Aprovimi i qendrave të trajnimit/ANTA	vit	100,000	
5	Aprovimi i personit të autorizuar për trajnim	pa afat	50,000	
6	Aprovimi për instruktorë në ANTA	pa afat	50,000	
7	Aprovimi i modifikimeve		100,000	Për avionët shtetërorë aplikohet 50% e tarifave të mësipërme

LIDHJA NR 5: LICENCAT E PERSONELIT FLUTURUES DHE TEKNIK

(000/lekë)

NR.	EMËRTIMI	AFATI	VLERA	SHËNIME
1	Licenca e inxhinierit të avionit tip 1&11	5 vjet	25,000	
2	Licenca e mekanikut të avionit tip 1&11	2 vjet	25,000	
3	Licenca e pilotit të linjave ajrore	2 vjet vlere kartoni	25,000	Për vazhdimësinë e licencës për çdo 6 muaj shtohet +10,000L. Në rastet kur vlefshmëria jepet një herë/vit kemi $25,000 + 20,000 \text{ L}$ për të gjitha mjetet fluturuese
4	Licenca e pilotëve komerciale	5 vjet/V.kartoni	25,000	Aplikohet njësoj si licenca e pilotit të linjave ajrore
5	Licence piloti privat	5vjet/V.kartoni	5,000	Kësaj vlere i shtohet +5,000L vlefshmëria për/vit & +10,000L/çdo dy vjet
6	Leje e pilotit student	5 vjet	5,000	
7	Licenca e navigatorit	5vjet/V.kartoni	25,000	Kësaj vlere i shtohet

				+10,000L vlefshmëria/vit
8	Licenca e inxhinierit të fluturimit	5vjet/V.kartoni	25,000	Kësaj tarife i shtohet +10,000L në vit
9	Licencë për stafin inxhiniero-teknik/ANTA	pa afat	6,000	
10	Licenca e dispeçerit	5vjet/V.kartoni	15,000	Kësaj tarife i shtohet +5,000L në vit
11	Licenca e stjuardesave	5vjet/V.kartoni	10,000	Kësaj tarife i shtohet +5,000L në vit
12	Licencë për kontrollor trafiku	pa afat	7,000	
13	Licencë për shoqëruese kabine	pa afat	8,000	

**LIDHJA NR. 6: LICENCAT E OPERATORËVE AEROPORTUALE
& LICENCA PËR AGJENCITË E SHITJES SË BILETAVE AJRORE**

NR.	EMËRTIMI	AFATI	VLERA	SHËNIME
1	Licenca e operatorit të aeroportit Ose Certifikata e operimit	1 vit	50,000€	Vlera në euro
2	Licenca e operimit të ANTA-s	1 vit	150,000€	
3	Miratimi i manualit operacional të aerob.		1,000.000	Shprehur në lekë Për çdo amendim, 10% e tarifës
4	Licenca e shërbimeve të sigurisë			Mbulohet nga tarifa e sigurisë
5	Leja për vetëshërbimet e karburantit	1 vit 5 vjet	100,000 500,000	Shprehur në lekë “ “
6	Leja për vetëshërbimet kargo	1 vit 5 vjet	50,000 250,000	Shprehur në lekë “ “
7	Leja për shërbimet e kateringut	1 vit 5 vjet	20,000 100,000	Shprehur në lekë “ “
8	Licenca e radio operatorit	1 vit 5 vjet	100,000 500.000	Shprehur në lekë “ “
9	Licencë për agjencitë e shitjes së biletave ajrore	6/muaj	30,000	Lekë; rinovim; jepet për periudhë 1 vit me të njëjtën vlerë